

ENGJËLLUSHE KARAJ

**FJALËT E PËRBËRA NË FJALORIN E GJUHËS SHQIPE TË
ALEKSANDËR XHUVANIT**

Fjalori i gjuhës shqipe i Aleksandër Xhuvanit pasqyron një pasuri shumë të vyer dialektore të areali të Elbasanit, por edhe të mbarë shqipes. Mbi këtë pasuri mund të sipërmerren studime të ndryshme: leksikore, semantike, morfologjike (sidomos për morfologjinë e fjalëformimit), sintaksore (autori të gjitha fjalët dhe kuptimet e tyre, si dhe njësitë frazeologjike, i ka dhënë me shembuj, së shumti me fjali), fonetike, historike, etnolinguistike etj.

Punimi ynë ndalet në grupin paradigmatic të fjalëve të përbëra në këtë Fjalor, grup që përfshin qindra e qindra njësi.

Fjala e përbërë është një nga njësitë leksikore me dukuri interesante të të gjitha rrafsheve gjuhësore. Ajo mund të shihet semantikisht, morfologjikisht dhe sintaksorisht (në funksionet sintaksore që luan). Fjalët e përbëra (kompozitat), në gjuhën shqipe janë nga më të studiuarat. Një nga studiuesit më të njohur në këtë fushë është prof. Androkli Kostallari me disa punime¹. Sipas tij, “Fjalë e përbërë ose kompozitë e mirfillët në shqipen është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy ose më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një teori e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta sintaktike gjithënjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj.”²

¹ A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe; Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese; Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes; Kompozitat dëshirore të dhe urdhërore të shqipes*. Të gjithë këta artikuj janë botuar në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, ff. 75-195.

² A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 83.

Edhe në Gramatikën e gjuhës shqipe (Morfologjia) ato kanë zënë një vend të veçantë. Po citojmë prej kësaj vepre konceptimi e tyre sipas mënyrës së fjalëformimit. Fjalët e përbëra formohen me kompozim. Sipas Gramatikës, “Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese; njëra nga këto (tema mbështetëse që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër (ose temat e tjera, kur janë më shumë se një) është e anjanësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore.”³

Në vazhdim, duke u mbështetur në këto përkufizime shkencore, ne do të bëjmë grupime e nëngrupime taksonimike për fjalët e përbëra në Fjalor, përmes tipologjive kuptimore dhe formale.

I. Vështrim semantik për kompozitat në Fjalorin e gjuhës shqipe të A. Xhuvanit

Duke u mbështetur në **kriterin semantik** ne jemi ndalur në dy grupe të mëdha fjalësh të përbëra: në kompozitat këpujore (kur gjymtyrët bashkohen në marrëdhënie këpujore ose bashkërenditëse të tipit vajtjeardhje: *vajtje dhe ardhje*, hyrjedalje: *hyrje dhe dalje*); dhe ato me marrëdhënie nënrenditëse (me marrëdhënie përcaktore të tipit: *ahmarrje* – marrja e ahut, *zemërgjerë* – me zemër të gjerë; krahasore të tipit *turidhelpër* – me turinjtë si të dhelpërës, *kokëkungull* – me kokën si kungull, kokëmushkë – që nuk i dëgjon koka si mushkës)⁴.

1. Kompozitat këpujore. Në Fjalor janë një numër relativisht të vogël, edhe pse kanë vendin e tyre në vepër, jo thjesht si njësi të regjistruara dhe që shprehin gjendjen gjuhësore leksikore në trevat nga janë vjelë dhe të cilave iu përkasin. Siç thotë edhe Kostaq Cipo, “Është natyra e shqipes, duket, që nuk i ka qejf formime të tilla. Kjo mungesë nuk dëshmon varfëri. Nuk është se s’kemi dvanva, kemi dhe të bukura, por janë të një tjetër natyre”⁵. Le të shohim disa shembuj nga Fjalori i Xhuvanit:

anepjesë,-t

...E qep a e bëj një punë shkel e shko pa kujdes; gr. ἀκροθιγώς.

...ishte futur kok’e këmbë këmbë e krye...

³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 70.

⁴ Gjithë shembujt ilustrues janë marrë nga Fjalori.

⁵ K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, në “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë, 1972, f. 61.

2. Kompozitat përcaktore (me marrëdhënie nënrenditëse), siç u shprehëm më lart janë të shumta. ndahen më tej në dy grupe të mëdha:

a) Kompozita endocentrike (kur njëra gjymtyrë e kompozitës përcakton tjetrën dhe kuptimi i kompozitës mbetet brenda kësaj lidhjeje nënrenditëse, si p.sh. *gjakhupës* = hupësi i gjakut, *gjakmarrje* = marrje e gjakut etj.

Në Fjalor gjejmë kompozita që në pamje të parë dalin si kompozita endocentrike, me marrëdhënie përcaktore emër + emër, por duke u mbështetur në shpjegimin e autorit të Fjalorit, ato dalin me marrëdhënie përcaktore emër + mbiemër. P.sh. *kungullngrënës* nuk zërthehet “ngrënës i kungujve”, por kungull i ngrënshëm. Sipas Xhuvanit kemi: **kungullngrënës, -i m.** Kungull që hahet (Himarë).

b) Kompozita ekzocentrike (kur marrëdhëniet semantike të kompozitave vendosen me një frymor apo një send, emërtimi i të cilit nuk është pjesë e kompozitës, d.m.th. semantikisht kompozita lidhet më dikë a me diçka që gjendet jashtë saj. P.sh. *fytyrëqeshur* nuk zërthehet semantikisht “fytyrë e qeshur” por “njeri me fytyrë të qeshur”, *zemërpërvëluar* nuk zërthehet “zemër e përvëluar” apo “zemër e djegur”, por “dikush me zemër të përvëluar”; *sypërmbysur* nuk zërthehet “sy i përmbysur”, por “njeri me sy të përmbysur”, *sypafjetur* nuk zërthehet “syri që nuk fle”, por “njeri që rri zgjuar; **njeri** gjithmonë vigjilent”. Pra, semantikisht qendra kuptimore e këtyre kompozitave është e jashtëvendosur, prandaj quhen ekzocentrike.

Në vijim po ndalemi në dukuri të tjera të rrafshit kuptimor të grupit të kompozitave ekzocentrike, që gjenden në Fjalorin e gjuhës shqipe të A. Xhuvanit.

1. Në përgjithësi kompozitat krijohen me një emërtim të drejtpërdrejtë pavarësisht se tipari i përket një frymori apo një sendi. P.sh.: *buzëhollë* - “që i ka buzët të holla”; *burrëvdekur* - “që i ka vdekur burri” ose “me burrë të vdekur”.

2. Disa kompozita ekzocentrike mund të dalin me përdorim dysh: me kuptim konkret dhe me kuptim abstrakt dëshiror. Ka raste kur të Fjalori që është botuar në SF, jepen dy variante fonetike për një kompozitë dhe njërin variant e jep me kuptim konkret, kurse variantin tjetër e jep me kuptim dëshiror. Kështu në Fjalor ne gjejmë dy njësi si më poshtë, ku autori mund t’i kishte parë si një njësi të vetme:

syplasan mb., emf. I verbër, qorr; **ata syplasan** ata që nuk shohin, nuk kuptojnë realitetin; fr. aveugles.

syplasur-i mb. dhe *m.* Njeri me sy të keq; *e pa djalin ai syplasuri dhe e mori sysh.*

3- Në Fjalor gjenden kompozita që dalin vetëm me kuptim dëshiror edhe pse kuptimi konkret mund të ekzistojë në të folme, por nuk ka zënë vend në vepër. P.sh. **kryekputur,-i m.:** *Ai kryekëputuri* (për ta sharë, që iu këputë kryet; **krahëthatë mb.:** *Mos qoftë njeriu krahëthatë e pa njeri të vetin* që i janë tharë krahët). Këto kompozita, siç shikohet edhe nga shpjegimi, janë të tipit *barkëtharë* - “iu thaftë barku”; *sydalë* - “i dalshin sytë”; *qafëkëputur* - “iu këputtë qafa” etj.

4. Gjithashtu, në Fjalor nuk janë të pakta kompozitat me kuptim dëshiror, si **barksh/uar,-ori m., barkashore,-ja f.** Barkthatë; barkshueme (?). Siç shihet mungesa e ilustrimit bën që kuptimi i kësaj fjalë të mos jetë plotësisht i qartë. Shpjegimi i saj është dhënë me dy kompozita: barkthatë = barktharë i pangopur, i uritur, dhe “barkshueme” = që iu shuajtë barku, mos lindtë fëmijë (në kuptimin dëshiror është dhënë me pikëpyetje). Në qoftë se kjo kompozitë do të kishte ilustrim më thënie e jo vetëm shpjegim, d.m.th. të ishte dhënë me fjali atëherë do të kuptohej se ishte kompozitë pronësore apo dëshirore.

5. Në Fjalor kemi një grup njësisht ekzocentrike që tiparin e sendit apo të frymorit e shënojnë në mënyrë të ndërmjetësuar. Kjo duket te kompozitat *emër + emër* që nënkuptojnë kuptimisht një marrëdhënie krahasore. Kështu *këmbëkizë* (*kambë-kiz/ë,-a*) do të thotë *Ai që i ka këmbët të shtrembëta si kiza*; apo *këmbëcipal* nuk do të thotë “këmbë prej cipali”, por i ka këmbët të holla si cipal. Tek Xhuvani e gjejmë: **këmbëcipal,-e mb.** Këmbëhollë, kërsihollë: *o Thanas këmbëcipali, a s’ t’ u derth një herë bari (baroti), pa të të thyhej stërralli.*

6. Te kompozitat ekzocentrike *emër + mbiemër*, shpesh, mbiemri është në kuptim të figurshëm dhe për pasojë e gjithë kompozita shndërrohet në mënyrë të figurshme. Konkretisht, kompozitat e mëposhtme shënojnë një tipar të figurshëm: *mendekërcyem; mendjeshkrehur; meskëputur; shpirtërrët; shpirtfëlliqur-i; shpirtmadh* etj. Madje kompozitat me fjalën zemër janë të gjitha me kuptim të figurshëm: *zemërdashun; zemërdhimsun; zemërgjanë; zemërgjerë; zemërher/ë-a; zemërkrunde-e-gërdhu; zemërngimë; zemërngushtë; zemërpadhimsun; zemërpërvëluar; zemërplasë; zemërplasme; zemërthyer; zemërzi, zemërzezë.*

7. Në Fjalor mund të gjejmë shumë kompozita, me një formë të mbarëshqipes dhe me një formë si variant dialektor i gegërishtes (bashkëjetesa mund shihet dhe si variant i toskërishtes dhe variant i

gegërishtes, duke pasur parasysh kohën kur janë mbledhur njësitë), si: *buzëplasun, buzëplasur; buzëqeshun, buzëqeshur; brikunorë, brikurorë* etj.

8. Gjithashtu, në Fjalorin e Xhuvanit gjenden disa kompozita ekzocentrike si variante dialektore vetëm të gegërishtes, si:

syqitëm-i *mb.* dhe *m.* Syqitun, njeri me sy të kërcyer, të dalë; fem. **syqitëme-ja**.

syqitun-i *mb.* dhe *m.* Që i ka sytë të nxjerrë pak jashtë, sh. edhe *syqitëm*.

9. Në Fjalor gjenden dhe kompozita me zanoren lidhëse **a**, një gjedhe fjalëformimi popullor interesant i shqipe: *hekakeq, hekakeqe* etj.

10. Kompozitat mund të shndërrohen edhe sipas semantikës përmes tropeve gjuhësore: nga emërtim ekzocentrik i një tipari të një sendi a frymori emërton vetë një send apo frymor. P.sh.:

dhamsut/ë,-a *f.* Guackë e vogël, e bardhë si dhëmbi i sutës; FGJSH, f. 99 edhe figurë e mitologjisë popullore.

dorëzonj/ë,-a *f.* Lule **dorëzonje**; turq. eli hanëm (se lulen e ka në formë të dorës së zonjës) lule mustaku

Relacionet semantike midis kompozitave

Kompozitat ekzocentrike në Fjalorin e gjuhës shqipe të A. Xhuvanit mund t'i analizosh edhe sipas marrëdhënieve / relacioneve leksiko-semantike midis tyre.

1. Kompozitat mund të hyjnë edhe në marrëdhënie antonimike. P.sh.: *buzangas / buzëpaqeshur; dorëlëshuar / dorështrënguet; derëhapur / derëmbyllur*.

2. Në Fjalor gjejmë dhe kompozita polisemike

val(ë)bukë-a, valëbuke-valëbukja *f.* 1. Gjym i vogël, një enë bakri me vegje, që merr 2-4 kg ujë e përdoret më fort për të bërë bukë me një valë: *fundi i fteres ose i valbukës* (Krue, Tiranë), FGJSH 596 *valbukë-valbukja*: gjym i vogël, ibrik zjarri. 2. Buka me një valë.

derëmbyll/ur, -me *mb.* 1. Për një burrë e grua që s'ka zotësi të rregullojë shtëpinë ose vëhten; s'di t'i matarojë punët e veta e të shtëpisë. 2. (Gjirokastër) Atij që i kanë vdekur njerëzit, i është mbyllur dera; i mjerë, fatkeq; edhe *i shuat*.

II. Përkatësia leksiko-gramatikore e kompozitave

a. **emra**: *ahmarrj/e,-a; anepjesë,-t; babëzot,-i, babzot-i; bal(t)dos/ë-a; buzërrafsh-i; dallapmbërtheck/ë,-a; dorëzënëj/e,-a; faibâm,-i;*

*gojëçthurrje; gojëkyçuri*⁶; *hekurthyes,-i; baraspeshim,-i; bukëval/ë,-a; bishtakuqës,-i; gurëgrack/ë,-a* etj.

b. **mbiemra:** *ahmarrës,-e; baftmadh; ballëngrehur; ballëhapët; ballëpërvjelun; dëngërrotë; flokëdërrudhur; fatnxirë; fatpadalë; vetëmlëmë (i), vetëmlëmë (e); vetëmlindur (i, e); vetmohues,-e; dorëpërdorët (i, e); derëmbyll/ur,-me; sylariskë; sylarush* etj.

c. **ndajfolje:** *kambadoras; kambëcingëthi; kambëcinkthi; kikëmajthi; kokangulthi; kokangurthi; guramçerthi; gurapekthi; guramçeftë; hapshalazi; hapashalthi; kukacerthi; syrambyllas; syrambyllazi; syrambyllthi, copëtrokë* etj.

ç. **folje:** *fatakeqem; kryeshtrohem; kundrëqëndroj; udhëheq* etj.

III. Përkatësia leksiko-gramatikore e gjymtyrëve të kompozitave

Më poshtë po ndalemi në përkatësinë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve të kompozitave në Fjalor:

1. Valencat e emrit:

emër + emër: *bishtgërshanë, pjesëmarrje, gojëshpell/ë,-i, bukëfike, bal(t)dos/ë,-a; shpagimmarrje;*

emër + mbiemër: *punëmadh-i, sybardh-i, nakarmadh,-e;*

emër + folje: *pishëvënë, faibâm,-i, pikëqelluem-i, emërsh/uar,-ori;*

emër + ndajfolje: *ballëhapët, gojëfarkuem,-i;*

numëror + emër: *njëkombas;*

folje + ndajfolje: *ngaskeq/e,-ja;*

folje + emër: *prishaplangës-i;*

ndajfolje + emër: *bashkëpunim, baraspeshim.*

2. Valencat e mbiemrit

emër + emër: *bishtgërshanë, dhambçakiç, faqerrogoz;*

emër + mbiemër: *gojëlik, gojambël, barkbardhë, ballëpërvjelun, ballëhapët, barkthatë, orëvdekur, ballëngrehur, pishëdhezur;*

numëror + emër: *njëkombas, katërcepatar,-e;*

emër + ndajfolje: *gojëshpejtë, dorëjashtë;*

emër + folje: *bukëdhanë, bishtdredhur bishtdredhur;*

emër + emër: *brymëshkrirës, brikunorë, trupderr, gojëshpellë;*

folje + ndajfolje: *ngran(ë)keq, hekakeq, vetëmlëmë (i);*

⁶ Shumë shpesh mbiemrat determinativë që zbërthehen me formulën *që e ka / e pastë + emrin e një pjese e trupit të njeriut + një mbiemër* emërzohen (kthehen në emër), pra nuk shënojnë një tipar por shënojnë mbartësinë e tiparit: **gojëkyçuri ai që e ka / që e pastë gojën të mbyllur.**

folje + mbiemër: *ngrënëzi*.

3. Valencat e foljes

emër + folje: *pikaderdhem, fatakeqem, udhëheq, kryeshtrohem*;

ndajfolje + folje: *kundrëqëndroj*.

4. Valencat e ndajfoljes

emër + ndajfolje: *gojëkyçur, syrambyllthi, syrambyllazi, kokangulthi*;

IV. Kompozita pronësore, ose siç quhen ndryshe *bahuvrivi*, janë ato kompozita ku komponenti i dytë përcakton të parin. Kemi zgjedhur për të pasqyruar në këtë punim ato kompozita që zënë një vend të gjerë në Fjalorin e gjuhës shqipe të A. Xhuvanit, ato me temë: *gojë-*, *sy-*, *krye-*, *kokë-*, *zemër-*, *buzë-*, *bark-*, *bisht-*, *ballë-*, *bukë-*. Ato janë si më poshtë:

gojë- (31): *gojambël, gojëckrehët, gojëçthurur, gojëçthurrje, gojëfarkuemi, gojëfarkuem, gojëfëlliur, gojëkyçur, gojëkyçuri, gojëlashtë, gojëleshuar, gojëleshuarje, gojëleshuem, gojëleshuar, gojëmbërthyer, gojëmbylluri, gojëndyrë, gojëpalá* edhe *gojëpalamë, gojëprishë* edhe *gojëprishëm, gojëprishur, gojësmbrazët, gojëshpejtë, gojëshpellë, gojëtharët, gojëvrazhdë, gojkeq, gojmirë, gojprapë, gojtharët, gojvrazhët*;

sy- (26): *sybardh, sybrimë, syketër, sylariskë, sylarm, sylarush, symbyllëtas, symbyllthi, syngimun, syngishëm, syngitë, syngushtë, sypafjetur, sypatrembur, sypetrit, sypërmbysun, sypishtar, syplasun, syplasur, syqitëm, syqitun, syrambyllas, syshbirues, syshkëndi*;

krye- (22): *kryekëcyem, kryekëput, kryekputur, kryekreje, kryekungull, kryelanë, kryelarëm, kryendezur, kryendëgjueshëm, kryengrehun, kryeparë, kryepicingul, kryesorrë, kryeshëndoshë, kryeshortas, kryeshplue, kryeshtrohem, kryeshtruem, kryeshtruat, kryeshyt, kryeunjët, kryezhytë*;

kokë- (3): *kokëmadhezë, kokëshkëmb*;

zemër- (13): *zemërdashun, zemërdhimsun, zemërgjanë* edhe *zemërgjerë, zemërherë, zemërkrunde-e-gërdhu, zemërngimë, zemërngushtë, zemërpadhimsun, zemërpërvëluar, zemërplasë, zemërplasma, zemërthyer, zemërzi*;

buzë- (10): *buzëburbuqe, buzëhollë, buzëkuqe, buzëpaqeshun, buzëplasë, buzëplasun, buzëplasur, buzëqeshun, buzërrafsh*;

bukë- (8): *bukëbakull, bukëbardhë, bukëdhanë, bukëfike, bukëpërmbysët, bukëshkalë, bukëvalë, bukëzi*;

bark- (7): *barkbardhe, barkdreq, barkkeq, barklubizë, barksgërropëm, barkshuar, barkthatë*;

bisht- (6): *bishtakuqës, bishtgërshanë, bishtdredhur, bishtkëpum, bishtluejtës, bishtpurtekë*

ballë- (3): *ballëhapët, ballëngrehur, ballëpërvjelur.*

Siç e shohim nga lënda e vjelë, mbizotërojnë kompozitat me fjalën *gojë*.

Autori ka parë dhe prirjet e zhvillimit të gjuhës duke mënjanuar edhe fjalë që i përkasin një të folme të ngushtë, p.sh. shqipja ka në përdorim kompozita me *kokë-, krye-, kaptinë-*. Në Fjalor ndeshen vetëm dy grupe paradigmatiske me kompozita me *kokë-* dhe me *krye-*, kurse me *kaptinë-* nuk ndeshim asnjë kompozitë. Ne i jemi referuar materialit të botuar. Pohimi do të jetë plotësisht i saktë vetëm pasi të verifikojmë të gjithë lëndën në kartotekë.

V. Shpjegimi kuptimor i kompozitave

1. **Shpjegim me perifrazim.** Zakonisht në Fjalor kompozitat jepen me shpjegim me perifrazim:

zemërthyer *mb.* Me zemër të thyer, të lënduar;

buzëhollë *mb., m.* Ai që nuk ha çdo gjë, po lyp gjëra të zgjedhura;

buzëplasë, buzëplase, -ja *mf., mb.* Që s'i ka qeshur buza kurrë nga vuajtjet (Himarë); sh. edhe *buzëpaqeshur*, edhe *buzëplasur*;

dallapmbërtheckë, -a *f.* Rafti që bëhet në mur; aty mbahen gjellë e tjera sende (Tiranë);

faqekuq, -e *mb. mf.* Që e ka faqen të kuqe, që është tërë shëndet;

gjakbam/ë, -i *m.* Që ka bërë gjak, që ka vrarë (Malësia), mund të mirret për kriminel;

gjakmarrës *mb.* Që i merr gjakun dikujt.

2. **Shpjegim me sinonimi.** Shumë herë shpjegimet e fjalëve të përbëra në tekst jepen nga autori me sinonimi. Më konkretisht:

cipëplasur *mb.* I pafytyrë, i paturp, faqezi, faqerrogos; *gojë* çthurur, *gojëlēshuem*, *gojëlashtë*, i zdatun; *tregohej* **cipëplasur** pa turp, fr. *effronté*, *imprudent*, *impertinent*, *insolent*, gjerm. *freck*, gr. *αύστολος*.

gojëlēshuem, gojëlēshuar *mb.* Gojëçthurur

gojambël *mb.* I ëmbël në të folë, fjalëëmbël;

faqerrogos *mb.* Cipëplasur.

ahmarrj/e, -a *f.* Hakmarrje.

ballëngrehur *ndf.* Ballëngritur, ballëlart.

gojëkyçuri *m.* Ujku (euf.).

gojëlashtë *mb.* (Shkodër) Gojëndytë,

gojëlëshuarj/e, - a f. Gojëçthurje.

gojëlik mb. Gojë prishur (Himarë).

gojëvrazhdë mb. Gojëfëlliqur.

3. Shpjegim me sinonimi dhe perifraksim:

zemërdhimsun mb. Zemërbutë, që i vjen keq për tjetrin;

zemërngushtë mb. Që preket e rrëmbëhet shpejt, nevrík; që s'duron;

zemërplasme mbf. Zemërplasur, thuhet për një grua, së cilës i ka vdekur ndonjë fëmi;

kryekungull mb. Ai që i ka kryet si kungull; fig. i trashë, budalla.

VI. Në Fjalor, siç jemi shprehur edhe herë tjetër (në punimin tonë të mikrotezës) ndeshen edhe shpjegime të pasakta. Konkretisht, kompozita e mëposhtme është markuar si mbiemër, por që shpjegimi është si emër. Shpjegimi i saktë do të ishte: “që është kokëshkëmb”.

kokëkrisur mb. Ai që është kokëshkëmb.

Apo e kundërta, kur kompozita është emër dhe shpjegimi bëhet me mbiemër. Kështu krahëthyemi duhet shpjeguar: “Ai që i ka krahët të thyer, apo ai të cilit i kanë thyer krahët”

krahathyemi mb. I mjerë, fatkeq, që iu kanë thyer, tha krahët.

Madje, te kjo kompozitë gjejmë të shkrira kuptimin konkret dhe kuptimin e figurshëm. Ky i fundit referon tek semat “që i janë tha krahët”. Madje ky kuptim është pjesë e strukturës së kompozitës *krahëtharë* sesa *krahëthyem*.

Ka dhe raste të diskutueshme siç është rasti p.sh. **gojëfarkuem-i** em. gjarpëri (për eufemizëm) (nga gojëfarmakuemi?) khs. gojëmylluri; sh. edhe SF 1972, 2, f. 194; autori e shoqëron me pikëpyetje /?/

VII. Kompozitat mund të jenë vjelje të drejtpërdrejta nga ligjërimi i folur ose i shkruar. Siç shikohet në shembujt e mëposhtëm (në kllapa janë vënë emrat e vendeve ku është dëgjuar fjala, apo nga është vjelë) kompozitat janë kryesisht vjelje nga ligjërimi i folur, me një shpërndarje të madhe gjeografike (Kosovë, Mat, Elbasan, Tiranë, Përmet, Gjirokastrë, Vlorë etj.), por nuk mungojnë në Fjalor edhe ato të vjela nga ligjërimi i shkruar (J. Vreto, F. Noli, K. Kristoforidhi, K. Negovani, Th. Mitko etj.). Konkretisht:

ahmarrës, -e mb. Ai që merr a kërkon të marrë hak (J. Vreto, Mirëvetija, f. 56).

ballëhapët ndf.: Rron **ballëhapët** përpara mendjes së vet (J. Vreto, Mirëvetija, f. 13): gr. ἀτρομητός, ἀτάροκος

ballëpërvjelun *ndf.* Ballëhapët (Kosovë).

bishtdredhur *mb.* Thuhet për një grua që e luan bishtin, që s'ka sjellje të mira morale (Gjirokastër).

bish(t)korrë *f.:* Për një **bishkorrë** u vranë deshët me kumborë për një palo vajzë (Vlorë); (Elbasan) bishtkorre-ja, leshkorre.

bishtakuqës,-i *m.* Zog me bisht të kuq (Përmet)

bithëmëkrahas,-i *m.* Njeri pa qendër: *ç'më flet për bithëmëkrahasit, ata ashtu janë mësuar* (Gjirokastër).

blanamorr,-i *m.* Një farë krimbi që bren drurin, tenja, molita; kompoz. nga morri i blanës (Mat).

brymëshkrirës,-e *mb.:* Vapë **brymë-shkrirëse** (F. Noli)

bukëbardhë *mb.* Dorëdhënë (Shpat-Elbasan).

bukëval/ë,-a, bukëval/e,-ja *f.* Një farë të ngrëne që gatuhet me miell gruri me vaj e piqet në furrë, bëhet për lindje fëmijësh; edhe *fuli-a, fli-a;* hoshmar, po me djathë (Skrapar)

bukëzi *mb.* Dorështrenguarm dorërrudhët (Shpat-Elbasan).

buzërrafsh,-i *m.* Një lloj peshku i lumit (Përmet).

dallapmbërtheck/ë,-a *f.* Rafti që bëhet në mur; aty mbahen gjellë e tjera sende (Tiranë).

zemërdhimsun *mb.* Zemërbutë, që i vjen keq për tjetrin (K. Kristoforidhi, Psall. CXVI, 6); *zemërdhimshëm.*

zemërgjanë, zemërgjerë *mb.* I duruar; FGJSH 631 *zemërgjerë*, *zemërkethjellët* *mb.* me zemër të këthjellët, pa prapamendim (K. Kristoforidhi, Psallt L, XXIII, 1).

ujmeturë (i, e) *mb.:* Vënt i **ujmeturë** me lagështi, gr. ύγρος, *vënt që zë dielli dhe është i ujmeturë* (J. Vreto, Mirëvetija, f. 68).

udhëheq *fk.:* Si e **udhëhoqë** atë ndë një të bukurë dhomë si e drejtoi, e shpuri (K. Negovovani, I drunjtë kryq, f. 10); më **udhëhoqi** ndë ky i miri *njeri* (K. Negovani, Dhonat..., f. 34) sh. edhe FGJSH 588.

udhëheqës-i *m.* Ai që **udhëheq** të tjerët në një punë (Th. Mitko, Bleta, f. 299)

vetëmlëmë (i), vetëmlëmë (e) *mb., emf.* gr. μονογενής; edhe i *vetëmlindur* (Kristoforidhi).

vetëmlindur (i, e) *mb., emf.* Edhe: i *vetëmlëmë* (Kristoforidhi), gr. μονογενής.

VIII. Më poshtë po japim një pjesë të fjalëve të përbëra të vjela nga ky Fjalor:

ahmarrës, -e; ahmarrj/e,-a; anepjesë,-t;

babëzot,-i, babzot-i; baftmadh; bal(t)dos/ë-a; ballëhapët; ballëngrehur; ballëpërvjelun; baraspeshim,-i; barkbardhe,-ja, barkbardh/ë,-a; barkdreq,-i; barkkeq,-i; barkklubizë; barkngim, -e; barksgërrop/ëm,-mi; barksh/uar,-ori; barkashore,-ja; barkthatë; bashkëpunim; bish(t)korrë;; bishtdredhur; bishtgërshanë; bishtkëpum; bishtluejtës; bishtpurtekë; bithalesh; bithëmëkrahas; blanamorr; brekthes; brektrashe; brezëmbrek,-u; brezvën/ë,-i; brikunorë, brikurorë; brymëshkrirës; bukëbakull; bukëbardhë; bukëdhanë; bukëfike; bukëpërmbysët; bukëshkalë; bukëval/ë,-a; bukëzi; burrëvdekur; buzangas; buzdele,-ja; buzëburbuqe; buzëhollë; buzëkuqe,-ja; buzëmëhundësh; buzëpaqeshun; buzëplas/ë, buzëplase,-ja; buzëplasun; buzëplasur; buzëqeshun; buzëqeshur; buzërrafsh; bythëprapë; bythëpul/ë,-a; cipëplasur; cmirzezë; copëtrokë, çëmër-math; dallapmbërtheck/ë,-a; degëmadh, -e; deledash; dëngëmadh,-e; dëngërrotë; derëhapur; derëmyll/ur,-me; derëmyllur, derëmyllëm,-e; diekeq,-e; ditëbardhë; djerraditë; dorëçelë; dorëdhënës,-i; dorëhapët; dorëjashtë; dorëlëshuar; dorëlëvizje; dorëmbarë; dorëmenja; dorëmënji; dorëpërdorët (i, e); dorështrënguet; dorëtharë; dorëzanë; dorëzënëj/e,-a; dorëzënës,-i; dorëzënësi,-a; dorëzonj/ë,-a; dosëbal/ë; dosëbalt/ë,-a; dritëshuajtës; duarmbërthyer; duartharë; dukakeq,-i, dukakeqe,-ja; dhambçakic; dhambëshkulë; dhambqitëm; dhambqitme,-ja; dhamsut/ë,-a; dhëmbërënë; dhëmbëstërrall emërsh/uar,-ori; ergjandashun; faibâm, -i; faqekuq; faqenxirë; faqerrogoz; farashuk; faregjë; farëgjëzë; fatakeq; fatakeqem; fatakequn (i, e); fatkeq,-e; fatkeqs; fatlum; fatmadh; fatmadh,-e; fatnxirë; fatpadalë; fjalëkeq; fjalëpar/ë, -i; fjalërandë; flokëdërrudhur; flokqethm/e,-ja; fytafyty; gjakbam/ë,-i; gjakhupës; gjakmarrës; gjëkafshë; gjetheshk/ë,-a; gjetheshumë; gjuhëprehët; gjuhëpreme; gjuhëthumb; gjymysami,-u; gjymysazog,-u; gllupgjerë; gojambël; gojëçkrehët; gojëçthurrje; gojëçthurur; gojëfarkuem; gojëfëlliur; gojëkyçur; gojëkyçuri; gojëlashtë; gojëlëshuar; gojëlëshuarj/e; gojëlëshuem; gojëlik; gojëmbërthyer; gojëmylluri; gojëndyrë; gojëpalá; gojëprishë; gojëprishëm; gojëshpejtë; gojëshpell; gojësmbrazët; gojëtharët; gojëvrazhdë; gojkeq; gojmirë; gojprapë; gojtharët; gojvrazhët; grikezën/ë; grykëgjanë; grykëngushtë; gunëbardh/ë; gunëdhirë; gunëzi,-u; guramçeftë; guramçerthi; gurapekthi; gurëgrack/ë,-a; gurthyese; haekëq,-i; hangëskeq, hagëskeqe; hekakeq, hekakeqe;

hekurthyes,-i; hesëkeq,-i; heskeq,-i; hiekeqme (e); hjekakeq,-i; huçkukur; hundëçip; hundëçutërr; hundëkrrut; hundëmadh; hundëpërpjetë; hundëshkabë;

kambë-kiz/ë,-a; kambë-likaçik; kambështrue; kamsorr/ë,-a; kashtë-bardh/ë,-a; kashtë-frutj/e,-a; kashtë-pendj/e,-a; kashtë-rronj/e,-a; katërcepatar,-e; këmbëcipal, -e; kikëkrisur; kikëmajthi; kohëshoku; kokëberr; kokë-gdhë; kokëhekur; kokëjashtë; kokëkrisur; kokëloçe; kokëmadhez/ë; kokëngjeshur; kokëngjylmazi; kokëpadëgjuar; kokë-rjepur; kokëshkëmb; kokë-shpell/ë; kokëshpell/ë,-i; kokëthat-i; kokëtrashë; komsorr/ë,-a; krahathati; krahathyem; krahathyemi; krahëhapur; krahëshkuar; krahëthatë; kryeati; kryebukëpjekësi; kryekëcyem; kryekëput; kryekputur; kryekungull; kryelarëm,-i; kryendëgjueshëm; kryendezur; kryengrehun; kryeparë; kryepicingul; krye-Profeti; kryeshëndoshë; kryeshortas; kryeshplue; kryeshterë; kryeshtrohem; kryeshtruem; kryeshtruet; kryeshyt; kryesorr/ë,-a; kryeulët; kryeunjët; kryezhytë; kukafsak/ë,-a; kundrëqëndroj; kungullngrënës; kungullujës;

lakadredhe,-ja; lakandreqem; lëkurpunues; leshpunues; leshralëshuar; lylyshtrydhe;

mashabig/ë,-a; mbajapaj/ë; mbyllasyza; mëmëzonj/ë; mendekërcyem; mendje-shkrehur; meskëputur; miknjerëzi,-a; mikprem,-i; mishollë; misemath; mollkuqe,-ja;

mundbjerrë;

nakarmath – nakarmadhe; nderpërmbysët; ndeshtrash/ë,-a; ngaskeq/e,-ja; ngranëkeq; ngrënëzi; ngullëmzi - ngullëmzeze;

njëkombas;

orëçuet; orëpremë; orëvdekur; orëzi;

pajambajtës; palëfik/e,-ja; pikëgoditur; pikëmesnat/ë,-a; pikëqelluem-i; pikërënë; pishëdhezur (pishëndezur); pishëvën/ë,-i; pjesëmarrj/e,-a; plangprishës-i; prishamende; prishaplangës-i; pritëpërsjellës-i; pulëvesh/e,-ja; punëher/ë,-a; punëmadh-i; punëmarë; punëmaruar;

qafëgrat/ë,-a; qafëkëputur; Qafëprushi; qafëshul; Qafëthana; qafëthyer,-i; qërtimemadh,-i

ragabardh-i; ragazi-u; rëngëmadh, -e; resëzeze;

rrashbuell-i; rremkeq, -e;

shkallëlartë; shpagimmarrj/e,-a; shpirtërrët; shpirtfëlliur-i; shpirtmadh; shpirtrobëri-a; shpirtrob-i; shtegëlamadh-i; shtëpidjegur; shtieq; shtisakeq, -e; shtjerakeq;

skepadrun-i; sybardh-i; sybrimë; syketër (i); sylariskë; sylarm-i, sylarm/e-ja; sylarush, sylarushe; syngimun; syngishëm; syngitë; syngushtë; sypafjetur; sypatrembur; sypërmbysun; sypetrit; sypishtar; syplasun; syplasur-i; syqitëm-i; syqitun-i; syshbirues; syshkëndi;

therëgjat/ë-a; thonjpaprërë-i;

trupderr; trushkulur; trutharë;

udhëheq; udhëheqës-i; udhëkryq-i; udhërrëfenjës-i; ujësjellës; ujëvjerrë; ujmeturë (i, e); val(ë)bukë-a, valëbuke-valëbukja; veshlabod; veshshpuar; vesk[ë]plotë; vetëmlëmë (i), vetëmlëmë (e); vetëmlindur (i, e); vetmohues, -e; vetullhollë; vetullmvrojtur; vetullnbiskonjë; vetulltrashë; vetullzi;

zemërdashun; zemërdhimsun; zemërgjanë; zemërgjerë; zemërkunde-e-gërdhu; zemërngimë; zemërngushtë; zemërpadhimsun; zemërpërvëluar; zemërplasë; zemërplasme; zemërthyer; zemërzi, zemërzezë; zorrëtharë; zubmadh-e.

Si përfundim, nga sa parashtruam vërejmë se grupi i kompozitave në Fjalorin e A. Xhuvanit vërteton dhe një herë atë që theksohet në Gramatikën e gjuhës shqipe (Morfologjia) se “Pas ndajshesimit kompozimi është mënyra më prodhimtare e formimit të fjalëve në shqipen e sotme. Kompozitat, duke pasur, të paktën dy tema motivuese, kanë zakonisht një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin më qartë e në mënyrë më të drejtpërdrejtë nocionin që shprehin, prandaj ato po marrin përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe njëkohësisht sa më ekonomike e koncepteve...”⁷

⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 70.

